



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 02/04

Datë: 11.03.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nr.03-V-074 të datës 12 dhjetor 2008 dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 mars 2011, mori

**V E N D I M**

1. Ndryshohet dhe Plotësohet Vendimi i Qeverisë, Nr. 08/39 i datës 08.10.2008 për themelimin e Komisionit Qeveritar për privatizimin e Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike.
2. Komisioni Qeveritar do të jetë në këtë përbërje:
  - 2.1 Z. Besim Beqaj, Ministër i Zhvillimit Ekonomik, kryesues;
  - 2.2 Znj. Mimoza Kusari Lila, Ministre e Tregtisë dhe Industrisë, anëtare;
  - 2.3 Z. Bedri Hamza, Ministër i Financave, anëtar;
  - 2.4 Z. Nenad Rashiq, Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale, anëtar;
  - 2.5 Z. Dardan Gashi, Ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, anëtar;
3. Komisioni Qeveritar sipas pikës 2. të këtij vendimi do të vazhdojë me procesin e privatizimit të Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe shfuqizon Vendimin nr 08/39 datë 08.10.2008.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë